



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 2042 Prot
Shkodër, më 22 . 11 .2021



SHKOLLA PROFESIONALE
HAMDI BUSHATI

SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
"HAMDI BUSHATI" SHKODËR

Nr. 408 Prot
Shkodër, më 22 . 11 .2021

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Kjo marrëveshje Bashkëpunimi lidhet ndërmjet:

BASHKISË SHKODËR me seli ligjore Rr. "13 Dhjetori", Shkodër, përfaqësuar nga Znj. Voltana ADEMI në cilësinë e Kryetares së Bashkisë.

dhe

SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE "HAMDI BUSHATI" SHKODËR,
përfaqësuar ligjërisht nga znj. Merita ZENELI në cilësinë e drejtores së Shkollës.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka për mbështetje bazën ligjore sikur vijon:

- Ligji nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- Ligji nr.15/2017 "Për arsimimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë";
- VKB nr.1, datë 22.1.2016 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër, i ndryshuar;

Duke qenë se: Bashkia Shkodër ka prioritet mbështetjen dhe zhvillimin e aftësisimit profesional të të rinjve në sektorë të ndryshëm të ekonomisë:

- Zgjedhjen e llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë.
- Zhvillimin dhe promovimin aftësisimit profesional dhe krijimin e kushteve të favorshme për të nxitur rritjen e kapaciteteve.
- Organizimin e aktiviteteve me bashkëpunimin e të gjithë të interesuarve që kanë fokus aftësimin profesional.

Palët bien dakort se më poshtë:



**Neni 1
QËLLIMI**

Kjo marrëveshje ka për qëllim bashkëpunimin për zhvillimin e aktiviteteve me fokus Arsimin Profesional, rritjen e kapaciteteve dhe promovimin e sektorëve me potencial për të rinjtë.

**Neni 2
OBJEKTI**

Marrëveshja ka për objekt organizimin e aktiviteteve promovuese, në fushën e Arsimit Profesional, sipas një kalendari të miratuar nga palet.

**Neni 3
AFATI I MARRËVESHJES**

Marrëveshja i shtrin efektet e saj për një periudhë 1 vjeçare që nga momenti i nënshkrimit të saj.

**Neni 4
GJUHA E MARRËVESHJES**

Gjuha e marrëveshjes është gjuha shqipe.

**Neni 5
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E BASHKISË SHKODËR**

- 5.1 Krijimin e kushteve të nevojshme nga ana e administratës së Bashkisë Shkodër për realizimin me sukses të aktiviteteve duke vënë në dispozicion territorin e kërkuar si dhe duke asistuar në nevojat logjistike për zhvillimin e aktiviteteve, me dakortësi mes palëve.
- 5.2 Siguron hapësirën e nevojshme publike për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta.
- 5.3 Promovon aktivitetet përbashkëta në media dhe në qytet përmes posterave, banerave etj, duke vënë në dukje bashkëpunimin me Shkollën e Mesme Profesionale "Hamdi Bushati" Shkodër.



Neni 6
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHKOLLËSË MESME PROFESIONALE
“HAMDI BUSHATI” SHKODËR.

- 6.1 Organizimin dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta sipas kalendarit të dakordësuar.
- 6.2 Promovimin e aktiviteteve të përbashkëta në media dhe në qytet përmes posterave, banerave etj, duke vënë në dukje bashkëpunimin me Bashkinë Shkodër.
- 6.3 Gjatë zhvillimit të aktiviteteve të Shkollës që zhvillohen në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, duhet të kujdeset për vizibilitetin duke përdorur krahas logove të Shkollës dhe të donatorëve të mundshëm, logon e Bashkisë Shkodër, në krye dhe në vende të dukshme.

Neni 7
KOMUNIKIMI

Çdo komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim. Palët do të caktojnë nga një person kontakti që do të jetë përgjegjës për të bashkërenduar aktivitetet e parashikuara në marrëveshje, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i informacioneve të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm

Për Bashkinë Shkodër:

- a) Znj. Voltana Ademi
Email: voltana_ademi@yahoo.com
Adresa: Rruga “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër

Për shkollën “Hamdi Bushati”:

- a) Znj. Merita Zeneli
Email: z_merita@hotmail.com

Neni 8
ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

- 9.1 Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të zgjidhë aktmarrëveshjen në mënyrë të njëanshme pa shkaqe të arsyeshme dhe para se të kenë njoftuar njëra - tjetrën me shkrim.
- 9.2 Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje apo kontraditë do të përipiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim.
- 9.3 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrëveshjes dhe procedurave juridike në fuqi, referuar legjislacionit në Republikës së Shqipërisë.



Neni 9
DISPOZITA TË FUNDIT

10.1 Kjo marrëveshje do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

10.2 Kjo marrëveshje u hartua në nga tre kopje në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë juridike nga të cilat njërën e merr Shkolla e Mesme Profesionale “Hamdi Bushati” ndërsa dy të tjerat i mban Bashkia Shkodër.

PËR
BASHKINË SHKODËR

PËR
SHKOLLËN E MESME PROFESIONALE
“HAMDI BUSHATI” SHKODËR,

KRYETAR

DREJTORE

VOLTANA ADEM

MERITA ZENELI